

E nderuar, zonja Kryetare e Kuvendit!

Te nderuar kolegë deputetë,

Të flasim për shqetësimet dhe problemet që kanë qytetarët, të cilët na kanë votuar për të qenë në këtë sallë jo si emra në borderotë e Kuvendit, as si kartonë që ngrihen dhe ulen, por realisht si shprehës të vullnetit të tyre, si zëri i shqetësimeve dhe i problemeve që ata kanë, nuk mjafton jo vetëm kjo seancë dedikuar çështjeve të evidentuara nga zgjedhësit, por edhe nëse seanca të tilla do të mbanim çdo ditë, sepse çështjet, problemet që evidentohen nga zgjedhësit, hallet dhe shqetësimet e tyre janë pa fund. Nuk them asgjë të re nëse përmend se shqetësimi më i madh është problemi pandëshkueshmërisë. Qytetarët ankohen se kur shkojnë në zyrat e shtetit nuk i pret askush për t'i dëgjuar, jo më për t'u zgjidhur hallet. Gjykatat nuk e dinë as vetë se ku janë e jo më t'u shërbejnë drejtësi qytetarëve, të cilët nuk i ndihmon dot as propaganda për reformën në drejtësi. Reforma pati mbështetjen e 140 deputetëve dhe të pjesës dërrmuese të opinionit publik, prandaj sot duhej të kishte bërë funksional të gjithë sistemin dhe jo gjykata gjysmake apo prokurori të trembura e të kontrolluara nga pushteti, e më shumë nga pushteti i korrupsionit, nga pushteti i parasë dhe nga pushteti i krimit. Ndërsa miratimi i kësaj reforme u prit me shumë entuziazëm, implementimi i saj hasi vështirësi, të cilat dita-ditës do të zbehnin besimin e qytetarëve. Pavarësisht vështirësive, mendoj se kjo reformë ishte dhe është e domosdoshme për vendin. Ndoshta do të duhet që sot ta analizojmë me kujdes implementimin e saj dhe ta vlerësojmë si një reformë jetike për shtetin e së drejtës në Shqipëri. Suksesit të reformës i shërben çdo debat për ta bërë këtë reformë sa më funksionale, që të arrijë qëllimin për të cilin u iniciua, aksesin e qytetarëve te një drejtësi e pavarur, e shpejtë dhe profesionale, ku të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, pavarësisht pushtetit që ushtrojnë apo financave që kanë në zotërim. Më lejoni që me shumë modesti të citoj një personalitet në fushën e së drejtës, ish-gjyqtar i Gjykatës së Strasburgut, zotin Ledi Bianku, i cili, në një intervistë para disa kohësh u shpreh se duhet të jemi mendje hapur, t'i diskutojmë problemet, të kritikojmë në mënyrë konstruktive, duke sjellë shembullin e gjykatësve te Gjykatës së Strasburgut, të cilët janë kritikët dhe debatuesit më të mëdhenj të atij sistemi gjyqësor. Debati konstruktiv i shërben reformës në tërësi, për ta vlerësuar ecurinë e saj, për ta përmirësuar dhe mbështetur, që sistemi gjyqësor t'i shërbejë individit dhe të drejtave të njeriut, jo pushtetit apo një grushti njerëzish. Do të ndalesha te një nga institucionet e reja të drejtësisë, Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion, që u krijua për të hetuar zyrtarët e lartë për korrupsion dhe krim të organizuar, e cila krijoi pritshmëri të larta për vetë realitetin në të cilin ndodhet vendi, ku pandëshkueshmëria është normë. SPAK-u hasi vështirësi në krijimin e tij, ku ndryshe nga përcaktimi kushtetues me 10 prokurorë, u krijua me 8, në kundërshtim me Kushtetutën. Nëse analizoj sot situatën e saj, sipas një studimi të fundit "SPAK-u në Sytë e medias", rezulton se SPAK-u ka ngarkesë dhe duhet të plotësohet sa më shpejt me BKH-në. Sipas përfundimeve, mungesa e kësaj strukture dhe asistencë kanë sjellë vështirësi në aspektin hetimor dhe organizativ, ndërsa është i domosdoshëm plotësimi i organikës së BKH-së me numrin e parashikuar prej 60 hetuesish. Raporti i fundit i Komisionit Europian konfirmon problematika të thella në sistemin tonë të drejtësisë, sepse drejtësia e vonuar është drejtësi e munguar. Në raport thuhet: "Efikasiteti i sistemit

gjyqësor është cenuar nga procedimet e zgjatura apo nga vendimet e pakta, që janë dhënë dhe nga dosjet e shumta që mbeten pezull”. Gjykatat e Apelit kanë një numër shumë të madh çështjesh të trashëguara dhe vakanca shumë të mëdha gjyqarësh, me 40 gjykatës në detyrë nga 78 që duhet të ishin gjithsej. Gjykatat me më shumë dosje të mbetura pezull janë Gjykata e Lartë me 36 mijë e 288 çështje dhe Gjykata Administrative e Apelit me 15 mijë dosje. Sot SPAK-u është para provës së besimit nëse realisht është Struktura e Posaçme Antikorrupsion. Fakti që i jemi drejtuar SPAK-ut është qasja jonë ndaj institucioneve të reja të drejtësisë, por edhe këto institucione duhet të dëshmojnë integritet dhe se nuk janë nën kontrollin e maxhorancës. SPAK-u është në provë për të dëshmuar përpara qytetarëve shqiptarë dhe partnerëve ndërkombëtarë, se është institucion i pavarur dhe jo i kapur, që zbaton ligjin dhe jo urdhrat politikë. Dosja e inceneratorëve është një shans që SPAK-u të dëshmojë se është institucion i luftës kundër korrupsionit. Zbardhja e kësaj afere korruptive, që ka një ndjeshmëri të madhe publike, duhet të bëhet sa më parë dhe të ndëshkohet kushdo që ka abuzuar me fondet publike. Koha e pandëshkushmërisë duhet të marrë fund. Këtë mesazh duhet ta japë kjo strukturë, e cila ka besimin e qytetarëve dhe barrën e provës për të dëshmuar profesionalizmin, paanshmërinë dhe funksionimin në bazë të ligjit dhe jo një strukturë e kapur nga politika. Faleminderit!